



**Shoqata e të Verbërve të Kosovës**  
**Kosova Association of the Blind**  
**Udruzenje Slepih Kosova**

# Revista “Syri Ynë”

Botim periodik i Shoqatës së të verbërve të Kosovës

Nr. 19



**Funded by  
the European Union**

Ky botim është publikuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e kësaj reviste është përgjegjësi e vetme e *Shoqatës së të verbërve të Kosovës* dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Tetor, 2023

# Përmbajtja

<i>Editrial</i> .....	<i>faqe 3</i>
<i>Java e njeriut me shkop të bardhë</i> .....	<i>faqe 4</i>
<i>Përkujtim: Mehmet Kastrati</i> .....	<i>faqe 8</i>
<i>Ndryshimet në rregullores së komisionit mediko social</i> .....	<i>faqe 9</i>
<i>Punësimi i personave të verbërve në kuadër të masës 1.6 të qeverisë</i> .....	<i>faqe 10</i>
<i>U mbajt kuvendi qendror i shoqatës</i> .....	<i>faqe 11</i>
<i>Kronika: Aktivitetet e shoqatës së të verbërve të Kosovës</i> .....	<i>faqe 12</i>
<i>QBMK, aktivitete në përmirësim të arsimit</i> .....	<i>faqe 15</i>
<i>Aktivtete sportive</i> .....	<i>faqe 18</i>

## **Këshilli botues:**

Enver Ulaj,  
Melihate Pllana,  
Bekim Krasniqi  
Florian Tishuki.

## Editorial

Tetori është muaji gjatë të cilit “Java ndërkombëtare e njeriut me shkop të bardhë” na përkujton angazhimin tonë të përvitshëm, për të sensibilizuar publikun për personat e verbër, nevojat e tyre dhe për të rritur angazhimet tona të përbashkëta lidhur me mirëqenien e komunitetit që përfaqësojmë. Është një javë në të cilën në komuna dhe anekënd Kosovës, në rrugë, ambiente dhe nëpër institucionet e Kosovës u dëgjua fjale personave të verbër. Zyrtarët, qytetarët dhe një publik i gjerë i njoftua me punë dhe arritjet, u bënë thirrje për më shumë angazhim dhe u prezantuan nevojat e komunitetit.

Këtë vit Java ndërkombëtare e njeriut me shkop të bardhë, vjen në vitin pasues pas Vitit 2022 kushtuar personave me aftësi të kufizuara, veprimet dhe fryma e së cilit ende është e pranishme në formë të referencave të aktiviteteve të realizuara, atyre që janë në vijimësi dhe rekomandimeve që kanë dalë dhe janë shpërndarë nëpër institucionet e Kosovës nga niveli lokal deri në qendër. Angazhimi përbashkët, udhëzimet e dala nga Qeveria, sensibilizimi nga Shqota e të verbërve dhe aketrët tjerë, si dhe nga vetë komuniteti, kanë ndikuar që në Kosovë të ketë më shumë se asnjëherë vetëdije për personat e verbër dhe obligimet që ka shoqëria për ta. Ashtu sikurse pushteti në të gjitha hallkat e tij, biznesi dhe vetë shoqëria ka më shumë se kurrë një pasqyrë shumë më të qartë të nevojave dhe obligimeve që ka secili.

Angazhimi personave të verbër në praktikë, krijimin e përvojave profesionale, poashtu ka qenë jashtëzakonisht i dobishëm dhe ka pasur efektin edukues të shoqërisë. Rezultatet e gjithë këtij angazhimi në bazë të gejrë i ka shijuar komuniteti gjatë këtij viti dhe në vazhdim.

Temat e mësipërme janë të parashtruara në artikujt e këtij numri të revistës “Syri Ynë”. Fatkeqësisht ka mbetur edhe shumë punë për t’u bërë, pasi nuk mjafton vetëm vetëdija dhe vullneti i mirë. Shoqëria duhet të krijojë mekanizmat për të garantuar statusin që ligji ua njeh personave të verbër. Prandaj ende ka shumë pabarazi, vështirësi me të cilat komuniteti nëpër ballët për çka shoqata është një proces të vazhdueshëm informimi, vetëdijesimi dhe avokimi.

Një pjesë e këtyre aktiviteteve janë të paraqitura në artikujt në vazhdim. Ato kryhen me mbështetje nga donatorët, dhe angazhojnë qindra persona që përpiqen për të dhënë kontributin secili në fushën e vet. Revista jonë paraqet vetëm një pjesë të vogël të këtij angazhimi që po ndodh anekënd Kosovës.

## Java e njeriut me shkop të bardhë

Java ndërkombëtare e njeriut me shkop të bardhë në datat 15-22 tetor edhe këtë vit është shënuar me një aktivitetesh që janë mbajtur në Kosovë organizuar nga Shoqata e të verbërve të Kosovës me partnerët e saj nga Qeveria e Kosovës, shoqatat ndër komunale dhe komunale të të verbërve, Qendrën burimor për mësim dhe këshillim Xheladin Deda, Bibliotekën për të verbër në prishtinë, etj.

Aktiviteti kryesor u mbaj në Prishtinë ku Shoqata e të Verbërve të Kosovës në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit mbajti një konferencë kushtuar Javës Ndërkombëtare të Njeriut me Shkop të Bardhë.

Konferencën e udhëhoqi drejtori i ZQM/ZK z. Habit Hajredini, ndërsa në panel ishte z. Daut Tishuki, kryetar i SHVK-se, z. Halil Kurmehaj, këshilltar i zëvendës kryeministrit të parë, znj. Luljeta Kabashi, nga MASHTI, znj. Leonora Nikçi nga KFOR-i, z. Bujar Kadriu u.d i drejtorit ekzekutiv në FKAK, Xhavit Kastrati drejtori i QBMK Xheladin Deda Peje, z. Rinor Ymeri nga Federata e sporteve për të verbër, dhe zyrtare të tjerë të institucioneve, përfaqësues të organizatave të personave me aftësi të kufizuara, persona të verbër dhe media.

Gjatë kësaj konference kryetari z. Tishuki, fillimisht bëri një prezantim të rëndësisë së javës së shkopit të bardhë, dhe gjithashtu theksoi nevojat që kanë personat e verbër në përgjithësi, por edhe u bë thirrje për veprim nga ana e institucioneve për zbatueshmërinë e ligjit për personat e verbër, edhe pse ka pasur nisma të mira siç është sinteza vokale në gjuhën shqipe, e cila është në proces për zhvillim të saj. Tishuki ka bërë një përmbledhje të historisë së javës së shkopit të bardhë deri në ditët e sotme dhe rëndësinë që ka ajo.

Habit Hajredini drejtori Zyrën për Qeverisje të mirë pranë kryeministrit tha se angazhimi me SHVK ka qenë i vazhdueshëm në aktivitete për shumë fusha. Në radhë parë iu referua sintezës vokale si një projekt dhe arritje madhore. Qeveria është në fazën e hartimit të strategjisë për personat me aftësi të kufizuara, që do jetë një ndihmës në vjetët në vazhdim, kurse një tjetër proces është ai i miratimit të Konventës së personave me aftësi të kufizuara në Kushtetutën e Kosovës, që është në proces për t'u miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, që pritet të shtojë angazhimet e institucioneve në mbrojtjen dhe garantimin e të drejtës së personave me aftësi të kufizuara në Kosovë.

Pas tyre kanë folur edhe znj. Luljeta kabashi për angazhimet që ka pasur Ministria e Arsimit, si një nga ministrinë e angazhuara shumë gjatë viteve të fundit, z. Halil Kurmehaj nga zyra e zëvendës kryeministrit tregoi aspektet ligjore të ndryshimeve që po ndodhin në legjislacioni kosovar duke përmendur Ligjin për zyrtaret publik që sapo ka hyrë në fuqi i cili normon punësimin e PAK si dhe miratimin e një akti të brendshëm për procedurat e punësimit të personave me aftësi të kufizuara, duke cekur edhe mundësinë e kryerjes së praktikës profesionale në kryeministri për personat e verbër.

Javës Ndërkombëtare e Njeriut me Shkop të Bardhë këtë vit përkon edhe me 20 vjetorin e themelimit të Shoqatës së të verbërve të Kosovës. Me këtë rast SHVK ndau këto mirënjohje për:

- kryeministrin e Republikës së Kosovës z. Albin Kurti, për angazhim në shpalljen e Vitit 2022- Vit i Personave me Aftësi të Kufizuara, vetëdijesim, angazhim dhe hapa konkret për qasje të barabartë për të gjithë.
- ministren e arsimit znj. Arbërie Nagavci, për krijimin e mundësive konkrete drejt zhvillimit të sintezës vokale në gjuhën shqipe
- mjeken Anita Mulolli Vrajolli, për kontributin e dhënë në vlerësimin e personave të verbër përmes Komisionit shtetëror mediko social
- Ejup Rashica, aktivist i dalluar i Shoqatës
- Enver Ulaj, për angazhim në aktivitete dhe fuqizimin e Shoqatës së të Verbërve të Kosovës
- Emine Prekaj Kuqi, për kontributin e dhënë në përmirësimin e jetës së personave të verbër në Kosovë

Ndërsa një mirënjohje post mort për aktivistin e ndjere Mexhit Foniqin, për kontributin e dhënë me vitet të tëra për personat e verbër.

Në javën e njeriut me shkop të bardhë organizohen për të ngritur vetëdijen dhe rritur angazhimin për personat e verbër në gjithë botë dhe zhvillohet në datat 15-22 tetor kudo në botë.

## **Një fjalë për Javën e njeriut me shkop të bardhë**

Shkruar nga Leonora Nikçi, nga revista “For You” e KFOR-it,

Java e Njeriut me Shkop të Bardhë nënkupton shumë më tepër se vlerësimin e një mjeti ndihmës. Ajo është dëshmi e qëndrueshmërisë, forcës dhe aftësive të jashtëzakonshme të individëve me vështirësi në të parë. Shkopi i bardhë është mishërim i fuqizimit, pavarësisë dhe vendosmërisë së palëkundur për tejkalimin e sfidave të jetës. Për këtë arsye, ne jemi mbledhur sot këtu jo vetëm për të nderuar shkopin e bardhë por, ç’është edhe më e rëndësishme, për të treguar respektin tonë ndaj këtyre individëve të jashtëzakonshme që ky shkop i përfaqëson. Sepse, ai është simbol i një komuniteti të njerëzve të veçantë të cilët e përshkojnë një botë përplot me pengesa me hir, vendosmëri, dhe shpirt të palëkundur. Në kuadër të këtij komuniteti ne gjejmë individë që i tejkalojnë kufizimet nga vështirësitë e tyre në të parë, duke u kredhur në udhëtime të mahnitshme të arritjeve, eksplorimeve dhe frymëzimit. Ata janë akademikë, artistë, profesionistë dhe ëndërrimtarë që e zgjojnë frymëzimin tek të gjithë ne. Një prej mënyrave se si ne e shprehim mbështetjen për komunitetin e personave të verbër dhe me vështirësi në të parë është përmes publikimit vjetor të revistës sonë në shkrimin braille. Ne besojmë që revista 4You Magazine në braille e luan një roj thelbësor në rrëzimin e pengesave. Përmes saj ne sigurohemi që personat me vështirësi në të parë të fitojmë qasje në një thesar të informacionit, tregimeve dhe ideve. Për më tepër, ajo e ofron një platformë për zërat që e meritojnë që të dëgjohen dhe tregimet që kërkojnë që të tregohen. Duke e pasur këtë parasysh, 4You Magazine, ngjashëm me Javën e Njeriut me Shkop të Bardhë, është një sistem mbështetës i çmuar. Ajo krijon lidhje mes nesh, nxit mirëkuptimin, dhe e instalon empatinë ndaj atyre, vendosmëria e të cilëve e ndriçon

rrugën përpara. Ajo qëndron si një dëshmi e përkushtimit tonë kolektiv ndaj gjithë përfshirjes, qasshmërisë, dhe mundësive të barabarta. Ajo shërben si një rreze e shpresës dhe unitetit. Gjithsesi, teksa e festojmë Javën e Njeriut me Shkop të Bardhë, ne duhet të reflektojmë edhe për punën që na pret në të ardhmen. Shtegtimi ynë drejt një bote me gjithëpërfshirëse dhe më të qasshme vazhdon përpara, dhe kërkon nga ne përkushtim dhe avokim të pakursyer. Le të frymëzohemi nga shpirti i palëkundur i atyre që mbështeten tek shkopi i bardhë për te përshkuar një botë që shpesh duket frikësuese. Le të na shërbejë kjo ndjenjë e përbashkët e unitetit sot si një forcë motivuese. Në fund, mos të harrojmë se fuqia e vërtetë e shkopit të bardhë nuk është vetëm në formën e tij fizike, por edhe në shpirtin, vendosmërinë dhe qëndrueshmërinë e atyre që e tunden atë. Për ne të tjerët, është detyra e jonë që të bëhemi kampione të mbështetjes, që të qëndrojmë si aleatë në betejën për të drejta të barabarta, dhe që të avokojmë për ndryshime pozitive. Duke ju falënderuar, uroj që Java e Njeriut me Shkop të Bardhë të vazhdojë të na frymëzojë të gjithëve që të ecim para dore përdore me personat e verbër dhe me vështirësi në të parë, duke i mbështetur ata ne rrugëtimin e tyre drejt një të ardhmeje me të ndritur dhe me gjithëpërfshirëse.

## Aktivitete e Javës së njeriut me shkop të bardhë nëpër komuna

Aktivitete për ndër të javës Ndërkombëtare të Njeriut me Shkop të Bardhë janë organizuar edhe nëpër qytet te tjera të Kosovës, përmes shoqatave komunale dhe ndërkomunale të të verbërve aktivitete nga më të ndryshme, sportive, kulturore por edhe konferenca Akademi dhe ngjarje te ndryshme.

Në shoqatën Ndërkomunale në Prishtinë janë organizuar tubim i anëtarëve për të diskutuar rreth aktiviteteve të parapara gjatë kësaj jave, janë organizuar gara shahu, shkrim lexim ne braill, punëtori artizanale, orientim në hapësirë dhe lojë futbollit.

Nga data 16.10.2023 deri më 19.10.2023, garat janë mbajte në Shqipëri, kurse turniri i futbollit për të verbër në Prishtinë me lojtaret e SHNV Prishtinës.

**Gjilan** me datë 19 tetor është mbajte një konferencë përmyllës me pjesëmarrës të ndryshëm institucional dhe bashkëpunëtor e kontribut dhënës në këtë shoqatë, gjithashtu gjatë kësaj konferencë përveç tjera është nda mirënjohës për ata që kontribuuan më shumë gjatë viti 2023 për shoqatën Ndërkomunale në Gjilan, dhe një ndër këta ishte edhe kryetari I shoqatës së të verbërve z. Daut Tishuki, për kontributin që po jep për personat e verbër që nga themelimi I shoqatës.

### **Prizren**

Edhe në Prizren janë mbajtur gara shahu për nderë të "Java Ndërkombëtare e Njeriut me Shkop të Bardhë" në SH.N.V.PZ, janë mbajtur aktivitete të ndryshme, një aktivitete ka qenë takim me gra

dhe vajza të verbëra të cilat kanë qenë me datë 17 dhe 18 tetor të cilat kanë qenë të mbështetura nga Departamenti I Kulturës rinisë dhe sportit Komuna e Prizrenit, me këta lojtarë dhe me këto barazime

1. Hysni Buqaj - 4 fitore 1 barazim,
  2. Përparim Krasniqi - 4 fitore 1 barazim,
  3. Kujtim Misini - 3 fitore 2 humbje,
- Ndërsa lojra u zhvilluan edhe me këta anëtare me lojërë miqësore
4. Valon Abdurahmani
  5. Sadik Kastrati,
  6. Yllka Berisha.

## **Gjakovë**

Shoqata e të Verbërve Gjakova me datë 16.10.2023 në ora 11:00 në Restaurantin Jeta Piskotë - Gjakovë hap Javën Ndërkombëtare të Njeriut me shkop të bardhë. Pjesëmarrës kanë qenë edhe figura publike si Kryetari i Komunës z. ARDIAN Gjini, deputeti kuvendi te Kosovës z. Hisen Berisha zyrtare komunal e asamblistë si dhe të ftuar të tjerë nga shoqëria civile.

Programi ka pas këto pika:

- Program Festiv
- Paisja e personave të verbër me aparatura akustike shëndetësore
- Turnir në shah
- Ndarja e mirënjohjeve

Mitrovicë janë mbajtur aktivitete të ndryshme një nga aktivitet më me rëndësi ka qenë marshimi në qytet me shkopi të bardhë, të cilët kanë pas për qëllim ngritjen e vetëdijes së opinionit publike për komunitetin e të verbërve

Gjithashtu edhe Istogu ka mbajtur Akademi solemne me zyrtare komunal dhe pjesëmarrës të ndryshëm për shënimin e Javës Ndërkombëtare të Njeriut me Shkop të Bardhë.

## Përkujtim

### Kolegut tonë Mehmet Kastrati ( 1957-2023)

Derisa ishim në përfundimin e kësaj reviste morën lajmin për vdekjen e aktivistit të shquar të shoqatës së të verbërve të Kosovës, kolegut e mikut tonë Mehmet Kastrati . Lajmi për ndarja e tij nga jeta në moshën 66 vjeçare na erdhi i papritur dhe na goditi të gjithëve. Kolegu ynë me të cilin ndamë vite të tëra jete, ndërroi jetë në kohën më të mire kur prisnim t'i kushtoj familjes të gëzojë jetën dhe pensionin e merituar.

Mehmet Kastrati ishte bashkëpunëtor dhe aktivist shumë vjeçar i Shoqatës së të Verbërve të Kosovës, kryetar aktual i Shoqatës Ndërkomunale të të Verbërve në Pejë i zgjedhur në kuvendin e vetëm disa muajve më parë, ish mësues dhe me shumë funksione në edukim në shkollën për të verbër- qendër burimore, veteran i arsimit dhe ndër të parët mësues udhëtues nga QBMK Xheladin Deda në Pejë. Gjithashtu për një kohë të gjatë edhe trajner i licensuar për ofrimin e shërbimeve në orientim e mobilitet për personat e verbër. Ishte punëtor i palodhsëm dhe aktivist i shquar për komunitetin, mik me secilin person të verbër, njeri i shakave, miqësisë dhe bashkëpunimit.

Ai la pas vetën bashkëshorten dy djem dhe një vajzë.

Me përhapjen e lajmit të papritur kanë ardhur shumë reagime dhe telegrame në vlerësimi të jetës dhe emrit të tij.

“Mehmeti, do të mbahet në mend si një bashkëpunëtor i yni gjatë. Ngushëllime familjes, anëtarëve të Shoqatës dhe kolegëve e bashkëpunëtorëve të Mehmetit. U prehtë në paqe kolegu ynë!” thahet në reagimin e SHVK

“Me dhimbjen më të thellë i bashkojmë ndjenjat me familjen e tij, miqtë dhe të afërmit. Zoti u dhashtë force të përballojnë humbjen” thuhet në dedikimin e QBMK Xheldain Deda ku ai ka punuar.

Forumi Kosovar i aftësisë është kufizuar poashtu në telegramin drejtuar familjes ka thënë se “me dhimbje të thellë morëm lajmin për ndarjen nga jeta me më të dashurit tuaj dhe bashkëpunëtorit dhe aktivistit shumë vjeçar të SHVK dhe bashkëpunëtorit tonë të devotshëm!

“Mehmet Kastrat dha kontributin e tij në edukimin e shumë brezave në shkollën tonë. Ndarja e tij nga kjo jetë mërziti jo vetëm pjesëtarët e familjes, por edhe të gjithë miqtë, kolegët e dashamirët e tij” thuhet në reagimin e shkollës “Pjetër Budi” në Dardani kua ai kishte punuar një kohë.

“Mehmeti ka qenë një prej mësuesve të parë që nga hapja e shkollës së të verbërve në Pejë në vitin 1982. Ai ka dhënë lëndën e historisë. U dëbua me dhunë nga kjo shkollë gjatë viteve të 90-ta vetëm se nuk pranoi rrethanat e aso kohe nga masat e dhunshme serbe. Pas luftës në Kosovë Mehmeti ishte ndër të parët mësues udhëtues që me plot sinqeritet kreu këtë mision të shenjtë, ku edhe u pensionua në qershor të vitit kaluar” thuhet në reagimin e shoqatës së të verbërve në Gjilan.

Kanë reaguar edhe degët e tjera të shoqatës së të verbërve të Kosovës, kryetarë të këtyre degëve, miq, shokë e aktivistë të shoqatave, ish nxënës dhe bashkëpunëtorë të të ndjerit.

Shoqata e të verbërve ka humbur me këtë rast një aktivist dhe një punëtor të shquar dhe profesional.



## Ndryshimet në rregullores së komisionit mediko social

Punëtori për plotësim ndryshimi e Rregullorja se Komisionit shtetëror mediko socila është mbajtur nga data 18 gusht deri me 20 gusht 2023, të cilën e ka kryesuar sekretari i Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve z. Enis Spahiu. Ndërsa pjesëmarrës kanë qenë zyrtare nga departamenti i pensioneve, nga departamenti ligjore, divizioni i komisioneve mjekësore dhe përfaqësues të organizatave me aftësi të kufizuara.

Gjatë kësaj punëtorie janë bërë plotësim ndryshimi i rregullores në fjalë që personat e verbër nuk do të kenë më rivlerësim dhe si rezultat i mos vlerësimit nuk do të ketë as mendim konsular i cili është mënjano nga rregullorja në fuqi, ku në të kaluarën ka paraqitë probleme dhe vështirësi për personat e verbër, pasi që ka pas rast kur kanë pritë me kohë të gjatë për rivlerësim dhe kanë mbetur pa kompensim edhe pse ato janë kompozuar me vone mirëpo jo ne kohen e duhur.

Pra, plotësim ndryshimi i kësaj rregullore i lehtëson personin e verbër që të marr kompensim pa u maltretuar nëpër komisione dhe marrinë e mendimeve konsulare.

Në rivlerësim do të thirren vetëm ata persona që ka indikacione, kur zyrtarët e departamenti të pensioneve apo dikush tjetër që vërejnë se një persona i verbër po vozitë ndonjë mjet trafiku dhe kjo e bënë rivlerësim pasi që personat e verbër mund të kompozohen në mënyre jo meritore.

Rregullorja pritet të hyn në fuqi 1 janar 2024

## Punësimi 6 mujor i personave të verbër në kuadër të masës 1.6 të Qeverisëkrijimi i mundësive për praktikë dhe vetpuënsim në të ardhmen

Masa 1.6 e cila është mundësuar nga Ministria e Financave Punës dhe Trasnferev, fillimisht për trajnim dhe pastaj për punësim të personave me aftësi të kufizuara.

Kjo nisëm fillimisht ka qenë 6 mujore praktikë/trajnim pastaj edhe 6 muaj të tjerë vazhdim i praktikës më mundësi punësimi më afatgjatë për personat me aftësi të kufizuara.

Shoqata e të Verbërve të Kosovës ka asistuar aplikim e të gjithë kandidatëve të mundshëm për praninë në këtë masë, mirëpo për shkaqe të ndryshme teknike disa na janë refuzuar në start sepse dokumentet e pranuar nuk i kemi pas në formatin e duhur apo sipas kriterëve të MFTP-së.

Mirëpo fatmirësisht 42 përfitues kanë qenë në 6 mujorin e parë ndërsa 19 kanë qenë që kanë vazhduar edhe 6 muaj të tjerë ndërsa deri me tani punësim me kontratë me afatgjatë i kemi 3 prej tyre, dy meshkuj dhe një femer. Janë punësuar në komunë Prishtinë një, Pejë një dhe viti një.

Mirëpo, SHVK ka përcjell këtë proces duke vizituar në vendin e punës personat e verbër dhe duke zhvilluar takime me bizneset pjesëmarrëse në këtë masë, me qëllim të krijimit të mundësive për punësim më afatgjatë dhe kushtet e përshtatshme për personat e verbër.

Mirëpo, në shumicën e bizneseve fatkeqësisht nuk kemi hasur në mirëkuptim, kanë qenë të hapur vetëm gjatë kohës sa është paguar nga ministria mirëpo pastaj kanë hezituuar që të vazhdojnë kontratë punë me personat e verbër, ndërsa ka pas edhe persona të verbër që ju ka ofruar puna por për shkaqe të natyrave të ndryshme kanë refuzuar.

Çka kemi vërejt në gjatë monitorimit të këtij procesi është se; ndonëse bizneset kanë vullnet për bashkëpunim dhe për gjetjen e mundësive të angazhimit të personave të verbër, mirëpo vështirësi financiare sipas tyre e bëjnë të pa mundur punësimin dhe krijimin e kushteve për një vend pune për këta persona.

Është cekë se pandemia Covid -19 ka sjell pasoja të mëdha të cilët ende po vazhdojnë të kenë efektin e tyre negativ dhe gjithashtu ngritja e inflacionit ka ndikuar edhe në bizneset kosovare.

Mirëpo, nuk është vetëm kjo arsyeje, sepse kemi pas raste fatkeqësisht kur edhe janë paragjykuar personat e verbër, për mundësi punësimi, duke ngritur çështje se çka munden të punojnë këta persona dhe po ashtu është kushtueshme përshtatja e vendit të punës.

Urojmë që bizneset që kanë mundësuar punësimin e 3 personave të verbër, të kenë suksese dhe të punësuarit të kenë një jetë të dinjitetshme e të merren model edhe për bizneset e tjera por edhe për motivim të të gjithë personave të verbër për angazhimin e tyre maksimal për të qenë të pa varur.

## U mbajt kuvendi qendror i shoqatës

Më 9 shtator 2023 u mbajt Kuvendi Zgjedhorë i Shoqatës së të Verbërve të Kosovës në praninë e delegatëve nga i gjithë vendi. Kuvendi shënoi përfundimin e një procesi nëpër komuna në të cilin janë zgjedhur edhe kryesitë e reja nëpër degët komunale dhe ndërkomunale, janë zgjedhur kryesi të reja apo janë konfirmuar udhëheqjet e deritashme që kanë marrë votat përsëri për një mandat tjetër. Në përgjithësi procesi ka qenë i suksesshëm dhe në shumë raste ka sjellë ndryshime pozitive që ndikojnë në krijimin e lidhjeve më të forta në komunitet dhe rritjen e rolit dhe efikasitetit të Shoqatës së të verbërve të Kosovës.

Kuvendi qendrat u mbajt në Prishtinë. Fillimisht u mbajt një minutë heshtje për nder të humbjes së anëtarit dhe aktivistit Mexhit Foniqi, i cili vdiq me 19 gusht 2023, dhe pastaj kuvendi hapi punimet.

Bazuar në statutin e Shoqatës në kohën e parapara që nga shpallja e thirrjes për kandidim, vetëm një kandidat kishte plotësuar kushtin, që është përgatitja e një programi dhe vendosja e kandidaturës për kryetar brenda afatit të paraparë për shpallje që kishte ndodhur në fillim të muajit shtator

Si kandidat i vetëm i këtij kuvendi për kryetar z. Daut Tishuki, i është paraqitur kuvendit të shoqatës. Ai ka prezantuar fillimisht programin e tij 5 vjeçar nëse do të zgjidhet edhe për një mandat. Ky program kryesisht ka për synim rritjen e kapaciteteve të shoqatës, avokim dhe lobim për përmirësimin e gjendjes së personave të verbër dhe përmirësimin e kushteve të tyre dhe realizmin e të drejtave të parapara me ligj. Në aspektin institucional është angazhimi pranë institucioneve kosovare për zbatim të ligjit, mbështetjen e shoqatës dhe përmirësimin e kushteve të jetës dhe mirëqenies së komunitetit. Në aspektin e funksionimit të shoqatës në prioritet ai ka paraqitur mbajtjen e stafit profesional të zyrën, rritjen e fondeve dhe ofrimin e shërbimeve psiko sociale për personat e verbër në Kosovë.

Ne prezencën e delegatëve të pranishëm pas paraqitjes së programit më pastaj është hapur debati lidhur me këtë program dhe pastaj është kryer votimi për kryetar të SHVK-së.

Me vota unanime u rizgjidh edhe për një mandat tjetër kryetari i deritanishëm Daut Tishuki, ndërsa u plotësua struktura e re udhëheqëse e organizatës. Derisa në postin e kryetarit kishte rizgjedhje, pozitat e reja pati ndryshime të tërësishme, duke sjellë anëtare dhe frymë të re në shoqatë. Kështu nënkryetare e parë u zgjodh Felona Bajrami, kurse nënkryetare e dytë nga komunitetet u zgjodh Sunçica Xhorxheviq.

Edhe Anëtarët e Këshillit Drejtues u zgjidhën kryesisht të rinj të angazhuar nga shoqatat nëpër komuna. U zgjodhën Arbësa Kreki, Valon Avdurrahmani, Muharrem Shala dhe Herolind Gashi. Gjithashtu, u zgjidhën edhe organet e tjera drejtuese të Shoqatës si forumi i gruas, forumi rinor dhe anëtarët e këshilli mbikëqyrës.

## Kronika e aktiviteteve të SHVK gjatë muajit shtator dhe tetor

Shoqata e të verbërve ka pasur aktivitete të ndryshme gjatë muajve shtator dhe tetor 2023. Ato zhvillohen sipas projekteve përkatëse, në partneritete apo si përgjigje në ftesat nga organizata me të cilat bashkëpunojmë

### **Panairi gjithëpërfshirës i punës**

Më 14 shtator SHVK ishte pjesëmarrëse në panairin e punës gjithëpërfshirës, ku takuam dhe biseduam me përfaqësuesit e kompanive pjesëmarrëse, te cilët i informuam për specifikat e punëkërkueseve nga komuniteti i të verbërve dhe falënderuam për gatishmërinë që kane shfaqur për angazhimin e personave me aftësi të kufizuara në përgjithësi.

Personat e verbër kanë vizituar panairin dhe shpresojmë se do të gjejn mundësi punësimi. Panairi u organizua nga Save the Children, Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar dhe Oda Ekonomike e Kosovës.

### **Promovimi i librit të autores Fjolla Muhaxhiri Agusholli,**

Më 21 shtator SHVK ka qenë pjesëmarrës në promovimin e librit “Trëndafili që nuk e vyshken stuhitë” me autoren Fjolla Muhaxhiri Agusholli, anëtare e shoqatës së të verbërve të Kosovës. Shoqata i uroj anëtares të saj znj. Fjolla, rrugëtim të mirë librit, por edhe autores suksese në rrugëtimin e saj bashkë me libra!

### **Reagim i përbashkët me HANDIKOS rreth benefiteve të energjisë elektrike**

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve të Kosovës- MFPT, më 5 shtator lansoi Programin për Mbrojtjen e Konsumatorëve të Cenueshëm në Energji Elektrike, i cili parasheh që përfitues të jenë familjet me të ardhura mesatare nën 150 € për anëtar.

Duke qenë se deri më tani, personat me status Paraplegjik dhe Tetraplegjik dhe personat e verbër në Kosovë, në reduktimin e faturave të energjisë elektrike kanë përfituar në bazë të Ligjeve në fuqi, ndërsa me këtë program, do të detyrohen të ri aplikojnë si formë të vetme, ne si organizata që mbrojmë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, shprehim shqetësimin tonë se një numër i konsiderueshëm prej tyre nuk do të mund të plotësojnë kriteret e kërkuara dhe shumë prej tyre do të eliminohen si përfitues nga kjo masë.

Njoftimin për këtë vendim e kemi pranuar direkt edhe përmes emailit nga Divizioni i Ndhimave Sociale, në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, se me nisjen e zbatimit të tij, nuk do ketë formë tjetër të subvencionimit të energjisë elektrike, për çfarëdo kategorie pensionale që kanë qenë përfitues më herët përmes Ligjit.

Si rrjedhojë, shtrojmë pyetjen tek Qeveria e Kosovës dhe MFPT, se më i rëndësishëm është një Ligj në fuqi apo një vendim pas tij, që mëton të përjashtojë shumë persona me aftësi të kufizuara si përfitues.

### **Konferenca kushtuar ditëve të njeriut me shkop të bardhë**

Bashkë me Zyrën p-ër qeprisje të mirë pranë kryeministrisë është shënuar dita e hapjes së Jvaës me një konferencë të mbajtur në hotel Sirius në Prishtinë. Kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga zyra e zënvëdës kryeministrit, Misntria e Arsimit, qendra Burimore Xheladin Deda dhe Forumi kosovar i aftësisë së kufizuar. Aktiviteti është përcjellë nga mediat dhe në të janë ndarë edhe mirënjohje për angazhimet lidhur me komunitetin e personave të verbër.

### **Trajnimi për Avokim, Lobim dhe Monitorim**

Me datë 24 tetor Shoqata ka marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga HANDIKOS trajnime në Avkim, Lobim dhe Monitorim

### **Trajnimin për menaxhimin e financave**

Ndërsa me datë 26 dhe 27, po merr pjesë në trajnimin për menaxhimin e financave të organizuar nga Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar.

Me datë 27 tetor dhe 28 takim i përbashkët me shqotën e të verbërve të Shqipërisë dhe shoqata ga Italia si dhe ekspert italian, u mbajt takimi për metodat dhe potencialin e mundshëm për hartimin dhe zbatimin e manualit të projektimit per personat e verbër dhe me shikim të dëmtuar për ndërtimin e lëvizshmërisë. Manuali apo udhëzuesi është i zbatueshmen ne vendet evropian dhe për këtë qëllim po behet përgatitja edhe për hartimin dhe zbatimin e tij në Kosovës e Shqipëri.

### **Pjesëmarrja e SHVK-së ne media:**

Më 12 tetor në emisioni “Rreth e rrotull” në TV Dukagjini ka qenë pjesëmarrës Bekim Krasniqi, menaxher i programeve në SHVK. Në këtë emisionin Bekimi, ka fokur për sfidat e personave të verbër por edhe ka prezatuar fillimin e Javës Ndërkombëtare të Njeriut me Shkop të bardhë.

Me 9 tetor në emisionin “Libero” në ATV- ka qenë pjesëmarrës Daut Tishuki, kryetar i SHVK-se u është bërë prezantimi e sfidave në literatur të personave të verbër, dhe gjithashtu ka folur për mësimin gjithëpërfshirës, për ofrimin e shërbimeve ne literaturë për nxënësit e verbër në shkolla fillore dhe të mesme në shkolla të rregullta por edhe për nxënësit ne Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshilli Xheladin Deda në Pejë, për rendësin e mësimit të hershëm dhe shërbimet

specifike për të verbër. Pastaj rëndësia e shkrimit të brailit dhe përpirësit në audio e cila është e përshtatshme për të verbër pasi që po punojmë për librat digjitale.

Ka foulur edhe për bashkëpunimin me shoqatën e Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut, Mali i Zi, por për shkëmbimin e materialeve janë pothuajse problemet e njëjta rreth materialeve.

Rtk 15 tetor 23 ka qenë pjesëmarrës në një intervistë për rendësin e Javës së Shkopit të Bardhe z. Daut Tishuki kryetar i SHVK-se

Me datë 24.10.2023 në Tëvë 1, z. Daut Tishuki, ka pas një interviste për jetën dhe sfidat e personave të verbër në përgjithësi por edhe për aktivitete që i zhvillon në SHVK si përfaqësues ligjore i saj.

Në muajin tetor është bërë publike në rrejtët social numër i revistës periodike Syri ynë numri 18 Ky botim është publikuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian.

## Aktivitetet e QBMK Xheladin Deda në edukimin dhe arsimimin e personave të verbër

Përveç procesit mësimor të përhershëm në edukimin dhe arsimin e personave të verbër në qendër zhvillohen edhe mjaft aktivitete tjera që kanë për qëllim ofrimin e përvojës dhe stafit tonë në ofrimin e kushteve më të mira për personat e verbër dhe në ngritjen e kapaciteteve të personave që punojnë me personat e verbër në institucione të ndryshme. Në vazhdim është një përmbledhje telegrafike e disa nga këto aktivitete, që kanë pasur dukshmëri më të madhe në publik.

### **Gjithëpërfshirja në edukimin fizik edhe në Lojërat paralimpike në Vushtri organizuar nga Komiteti Paralimpik i Kosoves.**

Qbmk Xheladin Deda Pejë si një promotor i zhvillimit të sportit për 15ftësi15u e kufizuar në Kosove në gara ftësi15 paralimpike mori pjese me sportistët ma a15ftesi dhe ish nxënës u dhe referë sportivë. Prezantuam ekipin e sporteve që mban emrin e "Shkolla" 15u, paraqitem për herë të parë me ekipin e xhudos për të verbër ftësi, dhe bashke me golballin e sportet tjera, paraqitem librin "Gjithëpërfshirja në edukimin fizik" para perfaqesueve të federatave, trjenreve dhe sportisteve.

Ishte poashtu edhe një 15ftësi15 për tu takuar me shumë sportiste dhe aktiviste që po 15ftësi15uojnë në zhvillimin e sportit të personat me 15ftësi të kufizuara

### **Mbështetje për asistent e ardhshëm që po shkollohen në komuna të ndryshme**

Kandidatët për asistentë për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore, kualifikimet e nivelit V të PEARSON nga Prizreni kanë vizituar gjatë muajit shtator shkollën. Dy grupe studentësh bashkë me profesorët e tyre kanë vizituar shollën dhe janë njohur me punë që bëhet dhe me përvojë të tyre. Po të njetin muaj ka qëndruar në shkollë edhe grupi i terti, ai i asistentet nga Prishtina që po ndjekin kualifikimet e nivelit V Pearson me të njëjtin program.

Qendra burimore në muajin shtator ka krijuar mundësitë e kryerjes së praktikës profesionale për katër asistentë nga rajoni i jonë, praktikë në kohëzgjatje 150 orë mësimore. Ndërsa më përfundimin e praktikës së tyre, në muajin tetor ka ardhur një tjetër student për kryerjen e praktikës.

### **Pjesëmarrjen në javën e njeriut me shkop të bardhë**

Më 15 tetor QBMK ka marrë pjesë në konferencë hapjes së Javës ndërkombëtare "Njeriu me shkop të bardhë", nga Zyra e Qeverisjes së Mirë pranë Kryeministrit dhe Shoqata e të Verbërve të Kosovës.

Mësimdhënësi i shkollës Enver Ulaj në këtë aktivitet mori një mirënjohje për kontributin në angazhime të përbashkëta të shoqatës, ndërsa në fjalën e folësve u tha se na presin angazhime tjera të përbashkëta.

### **Aktivitetet të përbashkëta me Qendrën për jetë të pavarur**

17 tetor. Në kuadër të javës së njeriut me shkop të bardhë QBMK Xheladin Deda priti mysafirët nga organizata Qendra për jetë të pavarur, që trajton persona të rritur me dëmtime intelektuale të llojeve të ndryshme. U zhvilluan aktivitete të përbashkëta, artistike, muzikore, sportive dhe darkuam së bashku në kuzhinën e përbashkët.

### **Defilim i përbashkët dhe vizitë në ekspozitën e piktorit Saimitr Strati në Galerinë e Pejës**

19 tetor- Java ndërkombëtare e njeriut me shkop të bashkë gjatë së cilës ne sensibilizojmë publikun dhe e vetëdijesojmë për nevojat dhe vështirësitë që kanë personat e verbër, si dhe bashkë me personat e verbër tregojmë praninë tonë, dëshirat dhe mundësitë.

Këtë ditë përgjatë qytetit të Pejës bëmë një xhiro të gjatë në këmbë me shkopa të bardhë, të përshëndetur nga kalimtarët dhe qëndruam në Galerinë e qytetit të Pejës me drejtorin Turhan Bajraktari dhe u kënaqem me ekspozitën e mrekullueshme të Saimir Strati & Friends. Nxënësit shijuan edhe mozaikët e Stratit, artistit shqiptar që njihet se ka thyer më se dhjetë rekorde Guinness.

### **Në turneun e shahit edhe ekipi i shkollës**

Klubi sportiv i Qendrës burimore ShS "Shkolla" në turneun e shahut që u mbajt në Shëngjin mori pjesë në kuadër të aktiviteteve kushtuar Javës ndërkombëtare të njeriut me shkop të bardhë

### **Takim i pare i drejtoreve te Qendrave Burimore të Kosovës**

Gjatë muajit tetor u mbajta dhe një takim i drejtorëve të qendrave burimore të Kosovës. Në takim u trajtuan dy tema: hartim i projekteve dhe mundësitë e aplikimit për projekte te donatorët dhe sfidat e përbashkëta dhe mundësitë e adresimit te tyre.

Takimet në formatin e tillë në të cilin qendrat burimore rrisin bashkëpunimin dhe koordinimin do të mbahen në vazhdimësi dhe takimi i radhës mbahet në Prishtinë

### **Vizita e Zëvendës kryeministrit të Kosovës në qendër burimore**

Para zëvendës kryeministrit të Republikës së Kosovës Besnik Bislimi prezantua punën dhe arritjet e stafit të QBMK Xheladin Deda. Ishte një mundësi e mirë për të biseduar për çështjet që e preokupojnë arsimin special në përgjithësi dhe shkollimin e personave të verbër në veçanti, për çka zëvendëskryeministri shfaqti një interesim dhe angazhim të veçantë.

Me zëvendës ministrin e financave Agon Dobruna identifikua angazhimet që mund të bëjë së bashku në vazhdim për krijimin e kushteve më të mira për edukimin e personave të verbër. Prania dhe angazhimi për zhvillimin e kësaj vizite nga z. Halil Kurmehaj, dikur nxënës i QBMK Xheladin Deda tash këshilltar i zëvendës kryeministrit është një tregues i arritjes që ka komuniteti i personave të verbër në Kosovë me angazhimin tonë të përbashkët

### **Në garën tradicionale të 11 në shkrim lexim nxënësi jonë fitoi vendin e tretë**

Prishtinë 25,Tetor 2023 - Me organizim tashmë tradicional për të XI-tën here me radhë biblioteka e të Verbërve e Republikës "Syri im " në Prishtinë organizoi Garat për Shkrim/lexim në Brail, një Aktivitet kulturor, për nder të Javës Ndërkombëtare të Njeriut me Shkop të Bardh ku edhe u shpallën fituesit e kësaj gare. Nxënësi jonë Uran Sylja nga Prishtina zuri vendin e tretë, kurse dy vendet e para i zunë ish nxënësi jonë Shqipëron Kuliqi nga Skenderaj si më i miri, e në vendin e dytë Gani Gashi. Teksa lexuesi i vitit në këtë bibliotekë u shpall Asllan Canolli nga Prishtina.

### **Punëtorja për udhëzuesin në fusha të aktiviteteve**

Pas marrjes së udhëzuesit nga ana e MASHTI, me ekspertin zvicerane Judith Hollenweger është mbajtur një punëtori online me të cilën ajo ka shpjeguar si të përdoret udhëzuesi i ri për programin Mësimi në fusha të aktiviteteve

### **Nga aktivitetet e tjera të Qendrës Burimore janë:**



Mbështetje për aplikimi ( në MKRS dhe Presidence UNICEF, HENDIKOS, FKAK për planifikimin strategjik)  
Aplikimi te FKAK për programin dhe trajner për gjithëpërfshirje me 10 komuna të Kosovës  
Përgatitja e 10 librave për lektyrën në braj për nxënësit e shkollës në bashkëpunim me Lions Club Istogu.  
Pjesëmarrje në aktivitetet e Java e shkopit të bardhë në Gjakovë  
Kordinimi me qendrat rajonale për një simpozium të përbashkët në praneverë  
Angazhimi në dy komisione pranë MASHTI lidhur me aftësinë ekufizuar.

# Aktivite Sportive

Federata e Sporteve për të Verbër ka zhvilluar disa aktivitete gjatë dy muajve shtator dhe tetor në lojëra shahu dhe globall.

Ndeshje sportive ka pas me grupin B kampioni i gola ballit ne palestrën e sporeve të universiteti ‘Fehmi Agani’ Gjakovë dhe grupi A palestra sportive “Hakif Zejnullahu” Podujevë

Ndërsa për ndër të javës ndërkombëtare të njeriut me shkop të bardhë ka mbajtur turnir shahu për të verbër ne Shëngjin në Shqipëri

## Lojërat paralimpike ne Vushtrri 2023

Komiteti Paralimpik i Kosovës organizon Lojërat parasportive “Kosova 2023”, ku do të marrin pjesë rreth 400 para-atlete nga vendet e rajonit, si nga: Kroacia, Mali i Zi dhe Maqedonia. Pjesëmarrës në këto lojëra ishin figura të shquara publike si Albin Kurti- Kryeministër i Kosovës Daulina Osmani-Zëvendës Ministre nga MKRS Emilija Rexhepi zëvendëskryeministre e Kosovës; Angelo Michele Ristuccia, komandant i KFOR-it etj, raporton Klan Kosova. Lojërat u mbajtën në Akademinë e Kosovës për siguri publike ne Vushtrri nga data 16.09.2023 deri me 17.09.2023.

Disiplinat qe u zhvilluan ishin: Gollball, Para-Volley,Basketbolli ne Karroca, xhudo për të verbër, Shigjetari, Ping pong, Boccia dhe aktivitete të tjera rekreative.